



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD- NR. 08/2025 PËR NDRYSHIMIN
DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.02/2013 PËR
PROGRAMIN DHE MËNYRËN E DHËNIES SË PROVIMIT PËR
PËRMBARUESIT PRIVAT¹**

¹ Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 08/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2013 për programin dhe mënyrën e dhënies së provimit për Përmbaruesit Privat, i nënshkruar nga Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë me datë: 03.10.2025 me Vendim Nr. 393/2025, të datës 03.10.2025.

Ministër i Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 335 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe Ligjin nr. 08/L-102, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD -NR. 08/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR.02/2013 PËR PROGRAMIN DHE MËNYRËN E DHËNIES SË PROVIMIT PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ nr.02/2013 për Programin dhe Mënyrën e Dhënies së Provimit për Përmbaruesit Privat (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi bazik).

Neni 2

1. Neni 4 i Udhëzimit bazik riformulohet si në vijim:

1. Ministria e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: Ministria), përgatit dhe publikon shpalljen për aplikim për provimin për Përmbarues Privat (në tekstin e mëtejme: provimi) në Sistemin Elektronik të Profesioneve të Lira (në tekstin e mëtejme: SEPL) dhe në faqen zyrtare të Ministrisë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para provimit.

2. Aplikimi për provim bëhet në mënyrë elektronike përmes platformës e-Kosova. Aplikimi përmban këto të dhëna:

- 2.1. emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin;
- 2.2. datën dhe vendin e lindjes;
- 2.3. të dhënat mbi arsimimin dhe njohuritë e fituara;
- 2.4. numrin personal;
- 2.5. të dhënat për përvojën e punës;
- 2.6. e-mail adresën;
- 2.7. numrin e telefonit;
- 2.8. adresën e vendbanimit apo vendqëndrimit;

2.9. kur është e zbatueshme, informatën që kandidati i takon e drejta për lirim nga pagesa;

2.10. pajtimin ose mospajtimin për publikimin e dhënave personale.

3. Me rastin e aplikimit për lejimin e dhënies së provimit për përmbarues privat, kandidatët ofrojnë dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara në dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme: Ligji), duke përfshirë:

3.1. kopjen e vërtetuar të diplomës së Fakultetit Juridik sipas programit katër (4) vjeçar ose të ketë të përfunduar studimet master. Në rast se kandidati ka kryer Fakultetin Juridik në ndonjë universitet jashtë Kosovës, duhet ta ketë të nostrifikuar diplomën e Fakultetit Juridik, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe dëshminë përkatëse për nostrifikim;

3.2. dëshminë për përvojën e punës në pajtim Ligjin.

4. Gjatë aplikimit ofrohen informatat dhe dëshmitë, të cilat vërtetojnë nëse kandidati është përfitues i skemës sociale apo i përket një kategorie që është liruar nga pagesa nëse është e zbatueshme.

5. Kandidati gjatë aplikimit zgjedh gjuhën zyrtare në të cilën do t'i nënshtrohet provimit.

6. Në rast të pamundësisë për aplikim në mënyrë elektronike në platformën e-Kosova, aplikimi mund të bëhet në mënyra tjera ashtu siç parashihet me rregullat për paraqitjen e kërkesës sipas Ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

7. Ministria i shqyrton të gjitha aplikacionet dhe vlerëson nëse kandidatët i kanë plotësuar kushtet për hyrje në provim.

8. Për kandidatin i cili i plotëson kushtet e parapara me Ligj, ministri nxjerr vendim, me të cilin kandidati i lejohej dhënia e provimit për përmbarues privat.

9. Nënshkrimi i vendimit nëse kandidati i plotëson apo jo kushtet për dhënien e provimit nga paragrafi 8, bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

10. Njoftimi i kandidatëve bëhet përmes platformës e-Kosova me sms apo e-mail dhe përfshin:

10.1. për kandidatët që plotësojnë kushtet: informatën për afatin, mënyrën dhe shumën e pagesës, si dhe paralajmërimin se nëse pagesa nuk kryhet, kandidati nuk mund t'i nënshtrohet provimit;

10.2. për kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet: këshillën juridike që përfshin edhe udhëzimin për paraqitjen e ankesës në mënyrë elektronike në platformën e-Kosova.

Neni 3

1. Neni 14 i Udhëzimit bazik, paragrafi 2 riformulohet si në vijim:

2. Komisioni nga paragrafi 1 i nenit 14 të Udhëzimit bazik mund ta autorizojë Sekretarin e Komisionit që ta njoftojë secilin kandidat përmes platformës e-Kosova me sms apo e-mail për rezultatin e provimit me shkrim. Kandidatët që e kalojnë provimin me shkrim, në të njëjtin njoftim informohen për provimin me gojë.

Neni 4

1. Neni 18 i Udhëzimit bazik, paragrafi 4 riformulohet si në vijim:

4. Lista përfundimtare e kandidatëve që kanë kaluar provimin futet në SEPL nga kryetari i Komisionit pas përfundimit të provimit me gojë brenda periudhës prej pesë (5) ditë pune. Përgjithësisht, këtë veprim mund ta bëjë edhe sekretari i Komisionit me autorizim të kryetarit të Komisionit.

2. Në nenin 18 të Udhëzimit bazik, pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 4.a. me tekstin si në vijim:

4.a. Njoftimi i kandidatëve për rezultatin përfundimtar bëhet përmes SEPL-së dhe përfshin:

4.a.1. kandidatët që me sukses e kanë kaluar provimin, duke përfshirë edhe udhëzimet për hapat e mëtejshëm të certifikimit.

Neni 5

1. Neni 20 i Udhëzimit bazik riformulohet si në vijim:

1. Kandidati i cili vlerëson se rezultati i tij përfundimtar apo rezultati nga njëra pjesë e provimit nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë, mund të paraqesë ankesë te Komisioni brenda tri (3) ditëve pas njoftimit për rezultatin përfundimtar, përmes platformës e-Kosova.

2. Komisioni është i obliguar që, në afat prej dy (2) ditësh pas ditës së pranimit të ankesës, të vendosë për ankesën.

3. Nëse e miraton ankesën, Komisioni mund të përsërisë provimin nga një apo më shumë lëndë apo të ndërrojë vlerësimin e dhënë më parë apo suksesin e përgjithshëm të përcaktuar.

4. Vendimi i Komisionit për provim është përfundimtar.

5. Nënshkrimi i vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 6

1. Në nenin 21 të Udhëzimit bazik, pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri 1.a. me tekstin si në vijim:

1.a. procesverbali përpilohet nga sekretari në SEPL.

2. Neni 21, paragrafi 2, nënparagrafi 2.14 riformulohet si në vijim:

2.14. nënshkrimi i procesverbalit bëhet nga kryetari, anëtarët dhe sekretari i Komisionit, në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 7

1. Neni 22 i Udhëzimit bazik, paragrafi 1, 2 dhe 3 riformulohen si në vijim:

1. Për kandidatët që kanë aplikuar për provim dhe kandidatët, të cilët e kanë kaluar provimin, Ministria mban evidencë elektronike, e cila krijohet nga SEPL-ja. Për kandidatët që e kanë kaluar provimin, mbahet edhe regjistër fizik.

2. Regjistri mbahet ndarazi për secilin vit kalendarik dhe mbyllet në ditën e fundit të punës të vitit përkatës. Në fund të vitit kalendarik, regjistri shkarkohet nga SEPL-ja, vërtetohet nga Ministria dhe arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 8

1. Neni 23 i Udhëzimit bazik, paragrafi 3, nënparagrafi 3.7 riformulohet si në vijim:

3.7. nënshkrimi i certifikatës bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

2. Në nenin 23 të Udhëzimit bazik, pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 3.a., me tekstin si në vijim:

3.a. në SEPL krijohet certifikata elektronike, e cila përmban të gjitha elementet sipas paragrafit 3 të nenit 23 të Udhëzimit bazik dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike, e cila mund të shkarkohet nga kandidati në çdo kohë përmes platformës e-Kosova.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Blerim SALLAHU

Ushtrues i Detyrës së Ministër i Drejtësisë

03.10.2025